

**DEPARTEMENT  
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**  
Abteilung Volksschule

Janar 2022

**Informacione për pranim në shkollat e mesme (Mittelschulen) dhe në shkollat profesionale me maturë (Berufsfachschulen mit Berufsmaturität)**

---

**1. Pranimi pa provim për nxënëset dhe nxënësit e shkollës Bezirk (Bezirksschule) dhe shkollës Sekundare (Sekundarschule)**

Nxënëset dhe nxënësit e shkollës Bezirk dhe shkollës Sekundare pranohen në bazë të notave në raportin e ndërmjetëm respektivisht me dëftesën përmbyllëse vjetore në shkollat e mesme si shkolla e mesme ekonomike (Wirtschaftsmittelschule WMS), shkolla e mesme e informatikës (Informatikmittelschule IMS), shkolla e mesme pedagogjike, mjekësisë, sociale, arteve, komunikimit (Fachmittelschule FMS) si dhe në shkollat profesionale me maturë (Berufsfachschulen mit Berufsmaturität BMS).

Nxënëset dhe nxënësit e shkollës Bezirk kanë mundësin shtesë sipas mesatarës të notave në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore të kualifikohen për gjimnazë (Gymnasium).

Lëndët që numrohen për pranim, janë të njëjta si për nxënëset dhe nxënësit e shkollës Bezirk po ashtu dhe për nxënëset dhe nxënësit e shkollës Sekundare.

Në shkollat e mesme (Gymnasium, WMS, IMS, FMS) pranohen vetëm nxënës të cilët janë nën 18 vjeç në momentin kur regjistrohen në shkollën e mesme. Nxënësit që janë 18 vjeç e lart nuk do të pranohen.

**2. Pranimi definitiv dhe jo definitiv**

Nëse nxënëset dhe nxënësit i përmbushin kërkesat (shiko 3.dhe 4.) në fund të gjysëmvjetorit të klasës përmbyllëse (raporti i ndërmjetëm), pranohen por jo definitivisht si në gjimnazë, në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e mesme të informatikës, si dhe në shkollat e mesme pedagogjike, mjekësore, arteve, komunikimit, sociale. Kjo do të thotë që ata duhet ta kalojnë kohën provuese në shkollën e mesme përkatëse të zgjedhur edhe për një gjysëmvjetor.

Nëse nxënëset dhe nxënësit i përmbushin kërkesat në fund të gjysëmvjetorit të dytë të klasës përmbyllëse (dëftesa vjetore), pranohen në gjimnazë, në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e informatikës dhe në shkollën e mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, sociale.

Pranimi në shkollat profesionale me maturë në të dy rastet, pra te përmbushja e kërkesave në fund të gjysëmvjetorit të parë po ashtu edhe në fund të gjysëmvjetorit të dytë është definitive.

### **3. Kërkesat për nxënëset dhe nxënësit e shkollës Bezirk për pranim në gjimnazë, në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e mesme të informatikës, në shkollën e mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, sociale si dhe në shkollat profesionale me maturë**

Për një pranim në gjimnazë pa provim duhet nxënëset dhe nxënësit klasën përfundimtare të shkollës Bezirk ta përfundojnë me këto të arritura:

- Në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore duhet në lëndët matematikë dhe gjermanisht më s`paku ta arrijë notën 4,0.
- Mesatarja e notave në raportin e ndërmjetëm si dhe në dëftesën vjetore duhet më s`paku të jetë 4,7. Notat në raportin e ndërmjetëm si dhe në dëftesën vjetore në matematikë dhe gjermanisht për mesataren e notave numrohen dyfish.

Për një pranim të lirë pa provim pranues në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e mesme të informatikës, në shkollën e mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, sociale dhe në shkollat profesionale me maturë duhet t`i përmbushin nxënëset dhe nxënësit e shkollës Bezirk në klasën përfundimtare këto kushte.

- Në raportin e ndërmjetëm si dhe në dëftesën vjetore në lëndët matematikë dhe gjermanisht më s`paku duhet ta kenë arritur notën 4.
- Mesatarja e notave në raportin e ndërmjetëm si dhe në dëftesën vjetore duhet më s`paku të jetë 4,4. Notat në matematikë dhe gjermanisht numrohen për mesatare dyfish.

#### **Përlllogaritja e mesatrës të notave**

Mesatarja e notave përlllogaritet me këto nota:

- a) Notat në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore të klasës përfundimtare në lëndët matematikë (numrohet dyfish), gjermanisht (numrohet dyfish), frëngjisht, anglisht, histori, biologji, kimi
- b) Prej tri lëndëve vizatim krijim/muzikë/ edukatë fizike: Numrohen dy notat më të mira në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore të klasës përfundimtare.
- c) Notat në dëftesën vjetore të dy klasave të fundit në lëndët gjeografi dhe fizikë

### **4. Kushtet për nxënëset dhe nxënësit e shkollës Sekundare për pranim në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e informatikës, në shkollën e mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, sociale dhe shkollat e mesme profesionale me maturë**

Për një pranim pa provim pranues në shkollën e mesme ekonomike në shkollën e mesme të informatikës, në shkollën e mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, sociale dhe shkollës profesionale me maturë duhet nxënëset dhe nxënësit e shkollës Sekundare në klasën përmbyllëse t`i plotësojnë këto kushte:

- Në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore duhet në lëndët matematikë dhe gjermanisht më s`paku ta arrij notën 4,0.
- Mesatarja e notave në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore duhet më s`paku të jetë 5,3. Notat në matematikë dhe gjermanisht përlllogariten për mesatare dyfish.

#### **Përlllogaritja e mesatarës të notave**

Mesatarja e notave përlllogaritet nga këto nota:

- a) Notat në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore të klasës përfundimtare në lëndët matematikë (numërohet dyfish), gjermanisht (numrohet dyfish), frëngjisht, anglisht, histori, gjeografi, biologji, fizikë, kimi

- b) Prej tri lëndëve vizatim me punë kreative/muzikë/edukatë fizike: numërohen dy notat më të mira në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore të klasës përfundimtare.
- c) Sipas organizimit të mbrendshëm të shkollës: nëse lëndët histori, gjeografi, biologji, fizikë, apo kimi nuk zhvillohen në klasën përfundimtare, numrohet nota përkatëse në dëftesën vjetore të klasës të dytë paraprake.

## 5. Ankimimi

Mesatarja e pikëve të notës përkatëse të transferimit është një vendim që merret nga rrethi ose shkolla e mesme në fjalë. Rruga e ankesave është e njëjtë si për vendimet e tjera të aftësive brenda shkollës fillore: Nëse nuk mund të arrihet asnjë marrëveshje midis prindërve, nxënësës / nxënësit dhe mësuesit, zyra përgjegjëse për vendimin brenda komunës<sup>1</sup>, pasi të jepet e drejta për t'u dëgjuar, duhet të marrë një vendim zyrtar, në përputhje me aftësitë.

## 6. Pranimi me provim pranues

Provimi pranues është i hapur për nxënëset dhe nxënësit, të cilët vijnë nga një shkollë private apo vinë të jetojnë në kantonin e Aargaut si dhe për nxënëset dhe nxënësit të cilët nuk kanë mund të kualifikohen pa provim pranues. Pjesëmarrja në provimin pranues për WMS, IMS, FMS dhe BMS lejohet për të diplomuarat dhe të diplomuarit të shkollës Bezirk dhe shkollës së mesme; provimi pranues për gjimnazin u drejtohet të diplomuarave dhe të diplomuarve të shkollës Bezirk.

Provimi pranues për gjimnazë, për shkollën e mesme ekonomike, për shkollën e mesme të informatikës dhe shkollës të mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, dhe asaj sociale mundet tek në vitin në vijim pas përfundimit të shkollës Sekundare apo shkollës Bezirk të absolvohet. Provimi pranues në shkollat profesionale me maturë mundet në përfundim të vitit shkollor të bëhet. Te të gjithë provimet pranuese gjithmonë vlerësohen me shkrim lëndët gjermanisht, frëngjishtë, anglisht dhe matematikë.

## 7. Paraqitja

Nxënëset dhe nxënësit me klasë përmbyllëse të shkollës Bezirk dhe shkollës Sekundare mundet me pëlqimin e prindërve deri me 28. shkurt përmes platformes për paraqitje që të lajmërohen në shkollat e mesme të dëshiruara. Departement Bildung, Kultur und Sport ([www.ag.ch/mittelschulen](http://www.ag.ch/mittelschulen) > Schultyp > Anmeldung)

## 8. Informacione të tjera

Informacione të tjera i gjeni nën [www.ag.ch/leistungsbeurteilung-volksschule](http://www.ag.ch/leistungsbeurteilung-volksschule) > Übertrittsverfahren (Procedura e kalimit)

---

<sup>1</sup> Këshilli i komunës mban përgjegjësinë e përgjithshme për shkollën. Me vendime zyrtare shkollore, si për shembull vendime aftësie, këshilli i komunës mund të ngarkojë një anëtar të këshillit ose drejtorinë e shkollës. Çdo komunë përcakton në një rregullore, çfarë zyre është kompetente për marrjen e vendimeve zyrtare shkollore.